



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	24.06	2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	SIKMBRRIK	3706/2022		1/3



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.522/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Kocanëtarë, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.522/2022 të datës 13.06.2022, të parashtruar nga ankuesi Skender Musa, të cilët me autorizim i përfaqëson avokatja me adresë

kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 24.06.2022, mori këtë:

### V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *Shpallet jo kompetent* për të vendosur për ankesën me numër A.nr.522/2022 të datës 13.06.2022 të parashtruar nga ankuesi

### A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", sipas akt emërimit të datës 20.02.2022 në pozitën Sekretar, përmes përfaqësuesit me autorizim me datë 13.06.2022 kanë parashtruar ankesë kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për kompensimin në pagën mujore të shkallës së inflacionit që nga data 18.04.2017 deri në shqyrtimin e ankesës.

Ankuesi i pakënaqur për mosrealizimin e kompensimit material me datën 13.06.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër protokollit 3399/2022.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 522/2022 të datës 13.06.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Kërkesë e datës 06.05.2022 për kompensimin e përqindjes së inflacionit; Njoftimi i datës 23.05.2022 lidhur me kërkesën e datës 06.05.2022; Autorizim për Shërbime Juridike i datës 19.04.2022 dhe Akt emërimi i datës 20.02.2022;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lëndës, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, *nuk është kompetent* për të vendosur për ankesën A.nr.522/2022 të datës 13.06.2022 të parashtruar nga ankuesi, *sepse*:

Nga shqyrtimi i provave materiale Kolegji ka konstatuar se ankuesi është i punësuar në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë.

Ankuesi me datë 12.05.2022 ka parashtruar kërkesë pranë Këshillit Drejtues dhe Komisionit për Konteste dhe Ankesa të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", lidhur me kompensimin e përqindjes së inflacionit. Këshilli Drejtues me datën 23.05.2022 ka njoftuar ankuesin se me datën 23.11.2021 ka nxjerrë vendimin për ekzekutimin e obligimeve financiare të cilat dalin nga Kontrata Kolektive.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në kuptim të pranueshmërisë së ankesës ju referua dispozitave të Ligjit NR.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 2 paragrafit 3 ku përcaktohet se 3. *Nëpunës Civil- është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë.* 4. *Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, dhe si rrjedhojë ka konstatuar se zyrtarët publikë të nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme në kuadër të institucioneve publike të arsimit të lartë të Kosovës, kanë statusin e nëpunësit të shërbimeve publike, respektivisht të njëjtit nuk janë nëpunës civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nen paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.522/2022 të datës 13.06.2022 të parashtruar nga ankuesi.*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në dispozitat e nenit 24 dhe 74 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konstaton se zyrtarët publikë me status të nëpunësit të shërbimit publik kanë të drejtë të ankohen te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojnë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nenparagrafi 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.522/2022, datë 24.06.2022.

Sabile Avdyli  
  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



**Vendimi i dërgohet:**

- ❖ Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit
- ❖ Sekretarit të Përgjithshëm në Universitetin e Prishtinës;
- ❖ Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Prishtinës dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

